



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 Nr. 118/02-6686
Datë 20.03.2018

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 90 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 03/L-147 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi z. Adnan Haxhibeqiri, i sistemuar në vendin e punës *Referent administrativ-financier ne sektorin e Sportit*, përfundimisht i përfundon marrëdhënia e punës me datë 28.03.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
2. Nëpunësit t'i llogaritet dhe paguhet kompensimi për shkak të pensionimit në lartësinë e një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit;
3. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A R S Y E T I M

Bazuar në evidencën e Zyrës së Personelit me saktësi vërtetohet se z. Haxhibeqiri me datë 28.03.2018 e arrin moshën 65 vjeçare, e cila me dispozita ligjore në fuqi është mosha e pensionimit, andaj është krijuar baza juridike për përfundimin e marrëdhënies së punës. Me dispozitat e nenit 19, të Rregullores nr. 33/2012, për Shtesat në Paga dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil, është paraparë që nëpunësi civil që arrin moshën e pensionimit, të gëzojë të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Bazuar në atë që u tha me larte, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh, prej ditës së pranimit e të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

Vendimi t'iu dorëzohet: z. Adnan Haxhibeqiri, Drejtorisë për Kulture, Rini dhe Sport, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa - Shërbimi i Pagave, Zyrës së Personelit dhe Arkivit.



Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini